



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
KËSHILLI I BASENIT UJOR “VJOSË”

VENDIM

Nr. 3_ Data 04.08.2017_

Për mos miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujqor në përroin e Dukatit, dega e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit “Dukat” për prodhim të energjisë elektrike, Fshatin Dukat, Bashkia Vlorë, Qarku Vlorë, subjektit “DEA HIDROPOWER” sh.p.k, me administrator Z. Gentian Priftaj

Në bazë të ligjit Nr.111/2012 datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të V.K.M 416 datë 13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", formulari D, dokumentacioni teknik, Vendimit Nr. 876, datë 14.12.2016 "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit Nr. 662 datë 21.09.2016 "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta", Vendimit Nr.5 datë 16.02.2016, Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujqor”, Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016, Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e Agjensisë së Basenit Ujqor”; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, shkresës zyrtare të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Nr.526, datë 21.10.2016 “Vënie në dijeni”,

VENDOSI

Mos miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujqor në përroin e Dukatit, dega e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit “Dukat” për prodhim të energjisë elektrike, Fshatin Dukat, Bashkia Vlorë, Qarku Vlorë, subjektit “DEA HIDROPOWER” sh.p.k, me administrator Z. Gentian Priftaj me këto të dhëna:

Koordinatat: X 43 76 557.236; Y 44 58 267.326; Z 270

Prurja mesatare : 1.1 m3/sek

Prurja e llogaritur: 1.8 m3/sek

Prurja e ekologjike: 0.085 m3/sek

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritetet të jetë 1450 kW



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
KËSHILLI I BASENIT UJOR “VJOSË”

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËSI A.B.U “VJOSË”

Ilir PROEKA

KRYETAR I K.B.U “VJOSË”

Etjona HOXHA